



Te mesuarit aktiv permes praktikimit te Aftesive te Konsultimi te Menaxhimit

(Resource ID: 263)

Durim Hoxha

durimi2000(at)yahoo.com

This teaching resource is allocated to following University:

UC - Universum College

Institution:

Universum College

<http://www.sustainicum.at/sq/modules/view/263.Te-mesuarit-aktiv-permes-praktikimit-te-Aftesive-te-Konsultimi-te-Menaxhimit>



Puna ne grup



11 deri ne 30
studente



Deri në 3 njësi
leksionesh



Lidhja me Web
e nevojshme



Anglisht, Shqip

Teoria integruese me rastet reale te biznesit eshte celsi per te mesuarin afatgjate. Konsultimi i Menaxhimit eshte nje subjekt pak a shume i ri, i cili ka nevojë për një përfaqësim të ndryshëm të mesimdhënies. Studentet do të pajisen me një metodologji të procesit konsultativ të menaxhimit, megjithatë ata duhet të përmbledhin njohuritë e mëparshme me qëllim që të prodhojnë një raport konsultues të vlefshëm. Duke përzgjedhur kompani specifike, studentet do të kenë mundësinë të veprojnë si konsultues menaxhimi dhe të bëjnë përpjekje për të përmirësuar strategjinë e tyre të tregut, të rritin shitjet, të sigurojnë kërkim dhe orientim tregu të besueshëm, të zhvillojnë burimet njerezore dhe të strategjisë të rritjes, etj.

Konsultimi i Menaxhimit ndihmon kompanite te zgjidhin problemet e tyre kryesore, te krijojne vlera me te larta, te pershpejtojne rritjen dhe te permiresojne performancen e biznesit. Konsulentet e menaxhimit perdorin biznesin e tyre dhe aftesite analitike te ofrojne ekspertizen me te mire dhe te zhvillojne aftesi qe vete kompania nuk i ka. Ata kryesisht merren me strategji afatgjata, strukture organizative, menaxhim dhe operime te nje organizate.

Konsultimi i Menaxhimit si nje fushe profesionale ne Kosove eshte ne fazen fillestare te zhvillimit. Nje skan i fundit i kapaciteteve te konsulenteve ne Kosove, theksoi se ka nje nevojte te ndjeshme per sherbimet konsultative ne anen e Ndermarrjeve te Mesme e te Vogla por kerkesa per keshillimin e biznesit e mirepaguar edhe e ulet. Faktoret kryesore qe pengojne kerkesen per sherbime keshillimi te biznesit ne Kosove jane mungesa e ndergjegjesimit te bizneseve te nevojave te tyre, mungesa e mjeteve financiare te ndermarrjeve per te perdorur sherbimet e konsulences dhe nje refuzim i bizneseve per te perdorur sherbimet e konsultimit dhe nje mungese besimi ndaj tyre.

Nje pjese e mire e konsulenteve ne Kosove nuk ka sfondin edukativ te mjaftueshem per ndermarrjen e puneve profesionale. Megjithate, pjesa me e madhe e konsulenteve te vezhguar e kane mbaruar edukimin e tyre ne fushen e biznesit dhe menaxhimit ne nivel universitar. Por nje e treta e keshilluesve nuk kane ndonje trainim specifik per konsulencen.

Duke u shtyre nga ky fakt, Universum College ka perfshire ne vitin e dyte te studimeve master kursin per Konsulence Menaxhimi. Qellimi eshte te promovojte midis studenteve profesionin dhe perfitimet e te qenit nje Keshillues. Megjithate, duke qene se ky kurs bazohet kryesisht ne praktikimin e aftesive, qellimi i ketij propozimi eshte te zhvilloje mjaft raste studimi nga studentet qe do te sherbejne si materiale te te mesuarit ne nje liber permbledhes per konsulencen e menaxhimit.

Studentet do te ndahen ne grupe me dy persona, dhe nje kompani specifike do te caktohet ku do te drejtojne nje diagnostikim biznesi dhe do te propozojne zgjidhje per problemet e identifikuara me pare.

Gjate kursit , studentet do te lidhen me Keshillin e Konsulenteve te Biznesit me qellim qe te mesojne me shume per aktivitetet e tyre dhe do te kene mundesi per te degjuar dy konsulente me pervojte si te ftuar nderi.



Mini-projekt për studentët Material i shkruar

Integrimi i palëve të interesuara shoqërore

- Komuniteti i Biznesit: Studentet do të duhet të vizitojnë kompanite shume here gjate kesaj periudhe, me qellim qe te diagnostikojne dhe diskutojne me kompanite per nje zgjidhje te mundshme.
- Keshilli i Konsultimit te Biznesit – nje shoqeri e cila mbledh keshilltaret qe do te perfshihen me qellim qe te lidhi studentet me keshilltaret me pervoje.

Pika e forte

- Pervoja e te mesuarit aktiv per studentet
- Rritja e ndergjegjesimit per perfitimet e profesionit te konsultimit midis studenteve dhe kompanive
- Zhvillimi i aftesive konsultuese
- Puna ne rrjet me konsulente dhe kompani

Pika e dobët

- Akses i veshtire tek kompanite
- Studentet mund ta konsiderojne si detyre te veshtire te punojne me kompanite
- Bashkepunim midis studenteve

Rezultatet e të mësuarit

- LT1 Te kuptojne procesin e konsultimit (5 faza)
- LT2 Te identifikojne ceshtjet qe e pengojne kompanine te performoje me mire
- LT3 Te prodhojne nje raport diagnostikues te biznesit te vlefshem duke ofruar edhe zgjidhje
- LT4 Te prodhojne nje projekt propozim per kompanine per zbatim

Lidhja për qëndrueshmëri

- Te rritin bashkepunimin e qendrueshem midis akademise dhe komunitetit te biznesit
- Te rritin ndergjegjesimin midis kompanive per lidhjen e konsultimeve

- Te kontribuojne tek zhvillimi i qendrueshem i kompanive te kerkuara
- Te prezantojne standartet e qendrueshme ne profesionin konsultues

Njohuri paraprake

- Njohuri te avancuara te praktikave te menaxhimit – Njohuri te avancuara te Menaxhimit strategjik dhe Menaxhimit te Burimeve Njerezore – Kerkimi i marketingut dhe sfondi i strategjise se Marketingut

Përpjekjet e përgatitjes

Mesatare

Përshkrimi i përpjekjeve të përgatitjes

- Pergatitja per leksione – Kontaktimi i Kompanive per te rregulluar vizitat ne terren – Liaison me Konsulentet e Keshillit te Biznesit dhe Konsulenteve me Pervoje

Aksesi

Free

Gjykimi / vlerësimi

Pjesemarrja dhe Kontributi ne klase
Rast studimi
Detyra finale

Kreditim/Çertifikatë

Asnje

Burime dhe lidhje

http://www.ilo.org/global/publications/ilo-bookstore/order-online/books/WCMS_PUBL_9221095193_EN/lang--en/index.htm

www.bcc-ks.org

Financuar nga

This teaching resource, realised within the project ConSus, has been

funded with the support of the TEMPUS of the European Union. The contents reflect the views of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.